

LINGUISTIC INTERFERENCES - ANALYSING THE ERRORS MADE BY ALBANIAN STUDENTS WHILE LEARNING A FOREIGN LANGUAGE

Shejnaze AJDINI-MURTEZI

University of Tetova, Faculty of Philology, French Language and Literature

shejnaze.ajdini@unite.edu.mk

Besa SALIU

besasaliu@hotmail.com

UDC 811.133.1'243:37.091.212

Professional paper

Abstract

In teaching foreign languages, the statute of error has evolved along with the various didactic tendencies, mainly because it is not considered as a negative sign which indicates a lack of knowledge on the part of the learner. However, language interference remains an important source of difficulties which the Albanian student is facing while learning the French language.

Preventing these interferences represents, at the same time, a challenge and a goal of the teaching process. This study deals with the analysis of errors, especially those in writing, made by Albanian high school students in the Republic of North Macedonia. Based on a considerable amount of written exams, this research aims to identify these errors as well as their source, in order to improve the teaching process of the French language.

Key words: *Analysis, error, interference, teaching, French language.*

Përmbledhje

Në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, statuti i gabimit ka evoluar përgjatë orvatjeve të ndryshme didaktike, sepse ai nuk është konsideruar si një shenjë negative, që tregon një mungesë të njohurive nga ana e nxënësit. Megjithatë, interferenca gjuhësore mbetet një burim i rëndësishëm i vështirësive me të cilat ballafaqohet nxënësi shqiptar gjatë të mësuarit të gjuhës frënge.

Të parandaluarit e këtyre interferencave paraqet njëkohësisht një sfidë dhe një qëllim për mësimdhënien. Ky studim ka të bëjë me analizën e gabimeve, sidomos të atyre me shkrim të nxënësve shqiptarë të shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë. Bazuar në një korpus të provimeve me shkrim, ky kërkim synon t'i gjëjë gabimet e bëra, si edhe burimin e të njëjtëve, me qëllim të përmirësimit të procesit të mësimdhënies së gjuhës frënge.

Fjalët kyçe: *Analizë, gabim, interferencë, mësimdhënie, gjuhë frënge.*

Hyrje

Në epokën e globalizimit, diversitetit gjuhësor e kulturor, mësimi i një apo më shumë gjuhëve të huaja është bërë një nevojë e patjetërsueshme. Në mësimdhënien e gjuhëve të huaja, gabimi paraqet një proces të domosdoshëm gjatë mësimnxënies, sepse nxënësi bazohet në gabimet e bëra me qëllim të tejkalimit të pengesave dhe të përvetësuarit më me lehtësi të gjuhës së huaj. Mu për këtë bien dakord edhe mësimdhënësit se, duke analizuar gabimet e nxënësve ne do të mund t'i tejkalojmë këto pengesa.

Pra, studimi jonë ka si pikënisje të detektojë gabimet e bëra gjatë provimit me shkrim, si edhe t'i kuptojmë faktorët kryesorë që ndikojnë në paraqitjen e tyre. Dihet mirë se kontakti ndërmjet gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj është njëri ndër faktorët kryesor në paraqitjen e interferencave. Këto interferenca shfaqen përshkak të dallimeve dhe ngjashmërive gjuhësore që ekzistojnë ndërmjet gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj. Pra të njëjtat paraqesin burim të gabimeve për nxënësin.

Faktorët të cilët ndikojnë në paraqitjen e interferencave gjuhësore

„Gjuhësia kontrastive konsideron që në fillim se mësimi i një gjuhe të huaj apo të dytë nuk paraqet problemet e njëjta sikurse mësimi i gjuhës amtare“.¹ Kjo hipotezë psikolinguistike është themelore për të gjitha kërkimet në kuadër të gjuhësisë kontrastive. Këtej rrjedh se mësimi i gjuhës së dytë dhe i gjuhës amtare dallon në më shumë nivele dhe që të mësuarit e gjuhës së dytë, i ndikuar nga ai i gjuhës amtare, kërkon përdorimin e një pedagogjie specifike të zhvilluar në funksion të ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet strukturave gjuhësore të dy kodeve në kontakt.

¹ Francis Débyser, *La linguistique contrastive et les interférences*, BELC, Paris, 1970, fq. 31.

Në planin neuropsikologjik, nxënësi shqiptar, nënkuptohet si të gjithë nxënësit që e mësojnë një gjuhë të dytë, nuk mund të përfitojë nga etapat e privileguara gjatë të mësuarit të gjuhës frënge, siç e ka mësuar gjuhën shqipe, sepse gjatë të mësuarit të kësaj të fundit, të gjithë etapat e përvetësimit janë të lidhura ngushtë me etapat e zhvillimit neurofiziologjik të fëmijës dhe shënojnë në të njëjtën kohë, fazat e njëpasnjëshme të zhvillimit të tij mental.

Në planin gjuhësor, të mësuarit e gjuhës së dytë bëhet duke u nisur nga të folurit kah sistemi i gjuhës për të cilin nxënësi bëhet i vetëdijshëm vetëm më vonë, gjegjësisht në moshën kur fillon të menduarit mbi gjuhën. Duke u nisur nga këto parametra, e që është mjaft e rëndësishme të theksohet për studimin tonë, përvetësimi i gjuhës frënge nga ana e nxënësve shqiptarë, çfarëdo qofshin masat e marra nga ana e mësimdhënësit, pëson ndikimin e gjuhës amtare, d.m.th të gjuhës shqipe, e sidomos shprehitë gjuhësore të nxënësit në këtë fushë.

Ky ndikim mund të ketë efekte pozitive, d.m.th. transferin dhe efekte negative, d.m.th. interferencat. Mund të thuhet se inventari i këtyre interferencave që duhet t'i interesojë autorët e doracakëve, metodologët, përpiluesit e programeve mësimore si edhe mësimdhënësit e gjuhës frënge të cilët me ndihmën e ushtrimeve korigjuese apo preventive duhet të përpiqen t'i zvogëlojnë interferencat.

Në këtë punim do të studiojmë ndikimin negativ të gjuhës shqipe në mësimin e gjuhës frënge, respektivisht të zbulojmë paraqitjen e interferencave dhe rrethanat e paraqitjes së tyre qoftë në aspektin psikologjik, pedagogjik e gjuhësor. Pra, qëllimi kryesor i këtij punimi është trajtimi i interferencave gramatikore dhe leksikore, duke bërë klasifikim e tyre, si edhe trajtimin e pasojave metodologjike, me qëllim të lehtësimit të të përvetësuarit të kuptimit të strukturës gramatikore dhe të fjalëve frënge nga ana e nxënësit shqiptar.

Për të arritur këtë qëllim, gjegjësisht për të formuar korpusin tonë, kemi filluar vjeljen e dokumenteve (provime me shkrim), por edhe vrojtme me gojë në orët mësimore të gjuhës frënge, me nxënësit e shkollave të mesme, prej vitit shkollor 2014/2015 deri në vitin shkollor 2017/2018. Përvoja ime si mësimdhënëse e gjuhës frënge në shkollë të mesme si edhe bashkëpunimi me kolegë, mësimdhënës po ashtu të gjuhës frënge ka qenë një ndihmesë e madhe në realizimin më të plotë të këtij punimi.

Interferenca, siç thekson edhe Debyser mund të përcaktohet në tri mënyra²:

a. Aspekti psikologjik

Sipas pikëpamjes psikologjike interferenca ka mundur të konsiderohet si një kontaminim i sjelljeve. Kështu fjalori i vogël i terminologjive i publikuar me qëllim që t'i dedikohet profesorëve të gjuhëve të gjalla nga shoqata amerikane M.L.A (Modern Language Association) e përcakton interferencën si «efekt negativ që mund të ketë një shprehje të të mësuarit mbi një shprehje tjetër».³ Sa i përket dallimeve në të mësuarit e gjuhës amtare dhe të huaj, pra gjithashtu mund të flitet edhe në planin psikologjik.

Këtu duhet përmendur se psikolinguistët gjatë kohë kanë konsideruar se një gjuhë e dytë mund të përvetësohet më së miri gjatë periudhës së fëmijërisë. Në vitet e '60 neuropsikologu Penfield besonte se zhvillimi fiziologjik i trurit ndikonte në të mësuarit e gjuhës, kapacitetin që rritet dalëngadalë derisa «zonat e të folurit të nguliten (forcohen)»⁴. E njëjta ide u përsërit nga Lenneberg, i cili pohon se pas «një periudhe kritike» e cila fillon prej moshës dy vjeçare dhe zgjat deri në pubertet, pason «një ngurtësim i funksioneve të ndryshme cerebrale», pra edhe gjuhësore dhe si pasojë e kësaj të mësuarit zhvillohet më me vështirësi.⁵

Dihet mirëfilli se motivimi luan një rol mjaft të madh në të mësuarit në përgjithësi, e në veçanti në të mësuarit e gjuhëve. Sa i përket mësimit të gjuhës amtare, fëmija veç ka një motivim natyral, pra nevojën që ai e ndjen për t'u integruar në shoqëri, ndërsa sa i përket gjuhës së dytë, ai nuk e ndjen më këtë nevojë, përshkak se veç më e posedon një mjet të komunikimit, pra nuk është shumë i motivuar të mësojë një gjuhë tjetër.

Teoritë moderne të psikolinguistikës tregojnë, megjithatë se të përvetësuarit e përkryer i një gjuhe të huaj mbetet plotësisht i mundur, sepse pas pubertetit si edhe në rastin e më të rriturve, nëse ata janë të motivuar dhe nëse posedojnë kohë dhe metoda të përshtatshme për mësimin e gjuhës së huaj, rezultatet nuk do të mungojnë. Këtej rrjedh se rëndësi të veçantë në mësimin e gjuhës së huaj ka motivimi i nxënësit. Përvoja ka treguar se vullneti dhe qëllimi për të mësuar paraqesin garancion të suksesit. Nxënësi i cili është i vetëdijshëm për qëllimet e të mësuarit dhe i cili ndjek një përçapje adekuate, me vendosmëri dhe energji të investuar, ka gjasa për të arritur sukses të dukshëm në mësimin e një gjuhe të huaj.

² Francis Débyser, *La linguistique contrastive et les interférences*, BELC, Paris, 1970, fq. 34.

³ Francis Débyser, *La linguistique contrastive et les interférences*, BELC, Paris, 1970, fq. 35.

⁴ William F. Mackey, *Bilingual interference: its analysis and measurement*, Québec, 1965, fq. 172.

⁵ Wolfgang Klein, *L'acquisition de langue étrangère*, Armand Colin, Paris, 1989, fq. 21.

Po ashtu, këtu duhet përmendur se sukcesi varet edhe nga prirjet e lindura për gjuhë. Pastaj, duhet përmendur se një memorje e mirë mund të ndihmojë mjaft, sepse sa më shumë që një person e zotëron një gjuhë, aq më lehtë do ta perfeksionojë dhe do të shërbehet me të.

b. Aspekti pedagogjik

Sipas pikëpamjes pedagogjike të gjuhëve të gjalla, Francis Débyser e definon interferencën si «një tip të veçantë të gabimit që e bën nxënësi i e cili mëson një gjuhë të huaj nën ndikimin e shprehive apo strukturave të gjuhës amtare». ⁶ Këtej rrjedh se gabimet interferenciale paraqiten si pasojë e ndikimit të gjuhës amtare. Në arsimin e mesëm, gjegjësisht në gjimnaze, gjuha amtare, gjegjësisht gjuha shqipe është më pak apo më shumë prezente varësisht nga metodat e përdorura, dhe si pasojë e kësaj edhe interferencat mund të jenë më pak apo më shumë të shprehura.

Këtej rrjedh se një analiza e metodologjisë së tanishme të mësimdhënies së gjuhës frënge është e domosdoshme për t'iu qasur më mirë interferencave gjuhësore. Planprogrami i mësimdhënies së gjuhës frënge bazohet në objektivat e pedagogjisë së mësimdhënies së gjuhëve të gjalla, ku përmbajtja përshtatet më përmbajtjen e doracakëve, të cilët njëzet vitet e fundit janë kryesisht të përpiluar dhe të botuar në Francë. Ajo që duhet theksuar është se Planprogramet zyrtare ndryshojnë shumë shpesh përmbajtjen duke u përpjekur që të fusin në Programin e ri, të dhënat më të reja të kërkimeve psikolinguistike.

Programet dhe mjetet pedagogjike ndryshojnë sipas niveleve. Doracakët e përdorur vitet e fundit janë: Agenda, Campus, Café Crème. Këto metoda i përfshijnë katër nivelet e ndërmjetme. Struktura dhe organizimi i të mësuarit në këto metoda janë të frymëzuara nga Korniza europiane për mësimin e gjuhëve të huaja. Ato janë të përcaktuar për nxënësit e shkollave të mesme.

c. Aspekti gjuhësor

Në aspekti gjuhësor, interferenca është studiuar në kërkimet shkencore të gjuhëve në kontakt, shumë shpesh ajo është përcaktuar si një aksident i dygjuhësisë. Sipas Mackey, «interferenca është përdorimi i elementeve që i përkasim një gjuhe tjetër, derisa flasim dhe shkruajmë në një gjuhë». ⁷ Siç thekson edhe Débyser, ⁸ është e dukshme se interferenca mund të prek gjithashtu edhe të kuptuarit, siç ndodh me prodhimin me gojë apo me shkrim të mesazheve.

⁶ Francis Débyser, *La linguistique contrastive et les interférences*, BELC, Paris, 1970, fq. 35.

⁷ William F. Mackey, *Bilingual interference: its analysis and measurement*, Québec, 1965, fq. 171.

⁸ Francis Débyser, *La linguistique contrastive et les interférences*, BELC, Paris, 1970, fq. 35.

Ka interferencë në pranimin e mesazhit, p.sh në rastin kur nxënësi shqiptar e kupton fjalinë e gjuhës frënge:

« Il viendra sans doute demain », si

« Il viendra sans faute demain », e jo si

« Il viendra probablement demain », ai bën një gabim interferencial të dekodimit duke u bazuar në analogjinë semantike të fjalëve në shqip dhe në frëngjisht «pa dyshim» dhe «sans doute». Meqë gabimet në të kuptuarit apo të dekodimit nuk vërehen drejtpërsëdrejti, në studimet e gabimeve sikurse edhe në analizat kontrastive, përcaktohem sidomos në përshkrimin e mekanizmave interferencial që kanë të bëjnë me prodhimin me shkrim apo me gojë.

Analiza e gabimeve

Sipas Aghaeilindi,⁹ analiza kontrastive është e para që i zbulon gabimet, vështirësitë dhe pengesat, të cilat paraqiten si pasojë e interferencave në mes të gjuhës amtare dhe të gjuhës së huaj. Metodot e reja të mësimdhënies së gjuhës frënge si gjuhë e huaj, për dallim nga metodat e mëparshme, gabimin e konsiderojnë si një dukuri natyrale gjatë mësimnxënies: Nëse mësimnxënia e një gjuhe të huaj është një aktivitet konjitiv për të bërë dhe verifikuar hipoteza në lidhje me strukturën e gjuhës së huaj, nxënësi detyrimisht do të bëjë gabime.¹⁰

Interferenca shfaqet në domene të ndryshme: fonetik, gramatikor, leksikor. Në këtë punim jemi përcaktuar t'i paraqesim gabimet interferenciale gramatikore. Interferenca gramatikore ka të bëjë me ndryshimin në strukturën dhe elementet strukturore të gjuhës frënge. Ajo trajton disa aspekte të gramatikës shqipe/frënge si: gjininë, numrin, parafjalët, nyjën, përemrat, mbiemrat, foljet vetvetore, etj. Këtu, ne do t'i paraqesim disa nga gabimet më potenciale që kemi mundur t'i hasim në prodhimet me shkrim dhe me gojë të realizuar me 60 nxënës të shkollave të mesme:

Exercices:

1. Mettez les mots au féminin

Versioni i nxënësve

| Mashkullore | Femërore |
|-------------|----------|
| le père | le mère |
| le garçon | le fille |

⁹ Somayé Aghaeilindi, *La pédagogie de l'erreur en production écrite dans l'apprentissage du français langue étrangère chez les étudiants persanophones*, Toulouse, 2013. fq. 29.

¹⁰ Clive Perdue & Rémy Porquier, *Apprentissage et connaissance d'une langue étrangère*, Larousse, Paris, 1980, fq. 43.

Versioni i korigjuar

| | |
|-------------|----------|
| Mashkullore | Femërore |
| le père | la mère |
| le garçon | la fille |

Për të sqaruar këtë shembull, duhet thënë se nxënësi ka bërë një gabim interferencial në gjuhën frënge, meqë në gjuhën shqipe nyja e shquar është e prapme, kurse në gjuhën frënge e përparme, kështu që nxënësi e ka të vështirë të bëjë këtë dallim.

2. Mettez les mots au pluriel

Versioni i nxënësve

| | |
|----------|-----------|
| Njëjës | Shumës |
| la femme | les femme |
| l'homme | les homme |

Versioni i korigjuar

| | |
|----------|------------|
| Njëjës | Shumës |
| la femme | les femmes |
| l'homme | les hommes |

Në gjuhën frënge bashkëtingëllorja –s nuk shqiptohet në fund të fjalës, kështu që nxënësit e bëjnë të njëjtin gabim edhe me shkrim.

3. Remplacez les mots soulignés par les pronoms c.o.d. et c.d.i.

- Nous cherchons **nos valises**.
- Elle parle à **Pierre**.
- Il écrit à **ses amis**.

Versioni i nxënësve

- Nous cherchons **les**.
- Elle parle à **lui**.
- Il écrit **leur**.

Versioni i korigjuar

- Nous **les** cherchons.
- Elle **lui** parle.
- Il **leur** écrit.

Vendi i trajtave të shkurtra të përemrave vetorë në gjuhën shqipe është i ngjashëm me atë të përemrave kundrinorë në gjuhën frënge, prandaj kjo nuk do të paraqiste ndonjë problem të madh gjatë mësimit të gjuhës frënge. Megjithatë, konfuzioni te nxënësi shqiptar paraqitet nga përdorimi i trajtave të plota në gjuhën shqipe, të cilat mund të përdoren para ose pas foljes. Për shembull:

U thashë atyre, ose Atyre u thashë.

Kështu që mund të themi se edhe në këtë rast ka një gabim interferencial në gjuhën frënge duke u bazuar në analogji me përdorimin këtyre përemrave në gjuhën shqipe.

4. Reliez les phrases avec les pronoms relatifs qui ou que.

- a. Je connais un restaurant japonais. Ce restaurant se trouve au centre ville.
- b. C'est une belle chanson. J'aime beaucoup cette chanson.

Versioni i nxënësve

- a. Je connais un restaurant japonais **qui** se trouve au centre ville.
- b. C'est une belle chanson **qui** j'aime beaucoup.

Versioni i korigjuar

- a. Je connais un restaurant japonais **qui** se trouve au centre ville.
- b. C'est une belle chanson **que** j'aime beaucoup.

Edhe në këtë rast përemrat qui apo que paraqesin vështirësi për nxënësin shqiptar, duke ngatërruar vendin e njëri tjetrit, në analogji me gjuhën shqipe.

5. Répondez au questions en utilisant les pronoms adverbiaux en et y.

- a. Vous venez de Paris?
- b. Tu vas au cinéma?

Versioni i nxënësve

- a. Oui, je viens.
- b. Oui, je vais.

Versioni i korigjuar

a. Oui, j'en viens.

b. Oui, j'y vais.

Edhe në këtë rast gabimi shkaktohet nga arsyeja e mospërdorimit të përemrave ndajfoljorë në gjuhën frënge nga ana e nxënësve shqiptarë, e kjo si pasojë e mosekzistimit të të njëjtëve në gjuhën shqipe.

Përfundimi

Si përfundim, mund të pranojmë se të mësuarit e një gjuhe të huaj mbështetet në ndikimin e gjuhës amtare, apo edhe të gjuhëve të tjera të përvetësuara më herët. Këto ndikime mund të jenë pozitive dhe negative, sepse në fakt ato mund ta lehtësojnë apo edhe ta pengojnë të mësuarit. Pra, ato paraqesin në të njëjtën kohë edhe pasuri por edhe pengesë, sepse çdoherë ekzistojnë ngjashmëri dhe dallime ndërmjet sistemeve gjuhësore.

Këtu gjithashtu duhet përmendur se për tejkalimin e këtyre pengesave, një faktor vendimtar është motivimi i nxënësit për të mësuar gjuhën në fjalë. Nuk duhet anashkuar në asnjë mënyrë rolin e metodave që do të duheshin të zgjonin interesin dhe kureshtjen e nxënësve, pastaj përshtatjen e të njëjtave me nivelin e nxënësve, si edhe të merren parasysh vështirësitë që dalin nga veçoritë e gjuhës amtare me qëllim të lehtësimit të procesit të mësimnxënies.

Bibliografia

AGHAEILINDI, Somayé (2013). *La pédagogie de l'erreur en production écrite dans l'apprentissage du français langue étrangère chez les étudiants persanophones*, Toulouse.

BESSE, Henry & PORQUIER Rémy (1991). *Grammaire et didactique des langues*, Paris: CREDIF.

DÉBYSER, Francis (1970). *La linguistique contrastive et les interférences*, Paris: BELC.

KLEIN, Wolfgang (1989). *L'acquisition de langue étrangère*, Paris: Armand Colin.

MACKEY, William F. (1965). *Bilingual interference: its analysis and measurement*, Québec.

MACKEY, William F. (1976). *Bilinguisme et contact des langues*, Paris.

PERDUE Clive & PORQUIER Rémy (1980). *Apprentissage et connaissance d'une langue étrangère*, Paris: Larousse.